

**STATUTI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TE**

**KUFIZUAR “GESÀ” SH.P.K**

**KREU 1**

**Themeli , Forma, Emri, Kohëzgjatja, Objekti dhe Selia**

**THEMELIMI I SHOQËRISË**

**NENI 1**

Duke u bazuar në ligjin nr 9901 datë 14.04.2008 “Për shoqërите tregtare” dhe në ligjin nr 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendren Kombëtare të Rregjistrimit”,

Unë Samije Paçrami i bija e Sherif-it e datëlindjes 01.10.1984, lindur dhe banues në Shkoder, me nr karte identiteti 035654665 dhe nr pesonal I46001100M

nën vullnetin tim të lire sot me date 13.03.2023 nënshkruaj miratimin e statutit të shoqërinë **“GESÀ” sh.p.k.**

**FORMA E SHOQËRISË**

**NENI 2**

Kjo Shoqeri do jetë “Shoqeri Tregtare” e formës “Shoqëri me Pergjegjësi të Kufizuar (sh.p.k)” “sh.p.k. Shoqëria zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi si dhe atë civil, doganor, tatimor, fiskal dhe akte të tjera ligjore mbi bazën e aktit të themelimit dhe statutit të saj dhe normat e të drejtës nderkombëtare .

**KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

**NENI 3**

Kohëzgjatja e kësaj shoqërie do te jetë pa afat duke filluar nga dita e rregjistrimit në Q.K.R për njohjen dhe rregjistrimin e shoqërise si përsone juridik.

## **EMËRTIMI TREGTAR I SHOQËRISË**

Kjo shoqëri do të quhet "**GESA.**" sh.p.k dhe vula e saj ka formën drejtkëndore në të te cilën do shkruhet "**GESA**" "sh.p.k".

## **OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

### **NENI 4**

**Objekti i veprimtarisë ekonomike te kësaj shoqërie është :**

Agjent i një subjekti financiar jo bankë. Arketime / Pagesa dhe transfera. Agjent komisioner I RAEA FS. Bileta avionic, trageti dhe autobusi. Change, Kembim Valutor. Agjensi turistike.

## **SELIA E SHOQËRISË**

### **NENI 5**

Kjo shoqëri do ketë selinë e vet në adresën Shkodër, Lgj. Qemal Stafa, Rr. BLV Zogu i I-rë, zona kadastrale 8594 , nr pasurie 2/54-N3/1.

## **KREU 2**

**Kapitali Themeltar, Organet e Shoqërise , Administratori ,Eksperti Kontabël dhe Prishja e Shoqërisë**

## **KAPITALI THEMELTAR**

### **NENI 6**

Kapitali themeltar i shoqërisë me perjegjesi te kufizuar është në 2,700,000 Lekë (dy million e shtatqind mijë) dhe përfaqësohet nga kontributi i anëtarëve themelues, i ndarë në 1 kuota me vlerë nominale të një kuote prej 2,700,000 Lekë (dy million e shtateqind mijë leke ) . Ortaku themelues i Shoqërisë zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

- Znj. Samije Paçrami , me vlere kapitali 2,700,000 Lekë (dy milion e shtatqind mijë leke) , zotëron 1 kuotëkorenspondere me 100% (qind) të kapitalit të shoqërisë .

Shoqëria çel llogari bankare në monedhën vendase (lek) si dhe çdo lloj valute tjeter në banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiarë të aktivitetit të saj.

Ortakët dhe administratori të caktuar nga shoqëria depozitojnë faksimilet e firmave të tyre origjinale në bankat ku është celur llogaria.

#### NENI 7

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie sipas dispozitave te kodit civil dhe atij tregtar.

Asambleja e ortakëve ka të drejtë të transferojë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pjesërisht ose tërësisht kontributet e saj përfshirë edhe fondet e kontributet në natyrë.

Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të janë të vërtetuara me akt notarial dhe për një gjë të tillë asambleja e përgjithshme duhet te marrë paraprakisht vendim me shkrim.

#### NENI 8

Kapitali themeltar i shoqërisë mund te rritet ose të zvogëlohet mbi bazën e vendimit me shkrim të Asamblesë së Përgjithshme, vendim i cili nënshkruhet prej saj dhe dokumentohet duke bërë dhe shënimet ne regjistrin përkatës.

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme shoqëria ka të drejtën që një pjesë të kuotave të kapitalit themeltar t'ia tjetërsojë një apo disa pësonave fizikë jashtë shoqërisë ose pësonave juridik, vendas apo të huaj mbi bazën e Aktit notarial te tjetërsuar .

Çdo vendim i Asamblesë së Përgjithshme për ndryshim të kapitalit themeltar i dërgohet menjëherë QKR-së.

#### NENI 9

Kapitali nuk mund te jetë kurrë i përfaqesuar me letra me vlerë dhe derdhja e kapitalit themeltar të shoqërisë bëhet para kërkesës së drejtar të QKR për njohjen dhe regjistrimin e shoqërise si person juridik.

Pjesët e kapitalit mund të transferohen të tretëve tërësisht ose pjesërisht .

## **ORGANET E SHOQËRISË**

### **NENI 10**

Asamblea e Përgjithshme është organi më i lartë drejtues dhe vendimor i shoqërisë dha ajo ushtron të gjitha kompetencat që ligji “Për shoqëritë tregtare: i njeh asamblesë së ortakëve.

Asamblea e përgjithshme mund t’ja delegojë kompentencat një ose shumë administratoreve caktuar prej saj dhe një pësoni fizik jashtë ortakerisë së shoqërië vetëm mbi bazën e prokurës.

### **NENI 11**

Me vendim të Asamblesë shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose me shumë ortakë të tjera shtetas shqiptarë apo të huaj ose të bashkohet me një shoqëri tjetër tregtare si brenda dhe jashtë vendit.

Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë vendos:

- ❖ Mbi ndryshimet në aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë
- ❖ Mbi formimin e filialeve degëve dhe përfaqësive jashtë vendit
- ❖ Mbi rritjen apo zvogëlimin e kapitalit themeltar
- ❖ Mbi ndryshimet në objekt dhe mbi blerjen e pjesëve të kapitalit në shoqëri të tjera
- ❖ Mbi transferimin dhe revokimin e likuidatorëve
- ❖ Mbi mënyrën e operimit me mjetet financiare monetare
- ❖ Mbi emërimin dhe shkarkimin e Administratorit

### **NENI 12**

Kjo shoqëri administrohet nga administratori Znj. Samije Paçrami i cili emërohet për një afat 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë ndryshimi me konsesusin e ortakëve.

## **EKSPERTI KONTABËL**

### **NENI 13**

Veprimet ekonomike financiare të shoqërisë mbyllen me datë 31 dhjetor të çdo viti. Për nxjerrjen e rezultatit kontabël mbi bazën e aktivit dhe pasivit ngarkohet nga asambleja e përgjithshme një ekspert kontabël i autorizuar.

Eksperti ka për detyrë të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare te shoqërisë akt gjithvletor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prejt tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë nga ana e asamblesë..

Në perfundim të kontrollit eksperti kontabël I autorizuar përgatit me shkrim, nxjerrjen rezultatit të bilancit vjetor si dhe atë per kontrollet periodike të ushtruara e cila është e detyruar t’ja paraqesë dhe dorëzojë në kohë ortakëve për t’I shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që kanë.

## **NENI 14**

Nxjerra e rezultateve të bilancit vjetor duhet bërë me saktësi duke respektuar të gjitha rregullat që përcaktohen nga ligji për kontabilitetin dhe atyre të sistemit të taksave që janë të detyrueshme per t'u zbatuar nga çdo subjekt privat që ushtron veprimitari tregtare.

## **NENI 15**

Bilanci kontabël vjetor miratohet mbi bazën e vendimit me shkrim të Asmablesë së Përgjithshme e cilajo vetëm që dokumenton miratimin e tyre por vendos në lidhje me disponibilitetin dhe garantimin e veprimitarisë së rregullt të saj duke patur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit te vecante etj.

## **NENI 16**

Të ardhurat neto (dividenti) që mbeten pas veçimit të fondevë ligjore të mesipërme dhe të atyre për shlyrjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbesin dhe i kalojnë në pronësi ortakëvë të shoqërisë sado qofshin ato.

## **PRISHJA E SHOQËRISË**

### **NENI 17**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkaku edhe para plotësimit të afatit për të cilën është krijuar siç mund të jenë, Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të mëtejashëm të veprimitarisë së saj një nga mënyrat e parashikuara nga ligji “Për falimentimin”

Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimitarisë tregtare.

Në këto raste Asambleja e Përgjithshmë merr vendim me shkrim në të cilin parashikohet mënyra e likuidimit të shoqërisë duke caktuar një ose disa likuidatore dhe duke shënuar ne çdo document të nxjerrë prej tij dhe emertesën “Shoqëri në likujdim e sipër”.

### **NENI 18**

Afati i emërimit të likuidatorit publikohet sipas kushteve që parashtron ligji përkatës duke specifikuar dhe dokumentet që duhen depozituar në aneksin e regjistrat në QKR.

### **NENI 19**

Përsa nuk është shprehur në këtë statut i referohet vendimeve plotësuese dhe të ligjshme, dhënë nga Asambleja e Përgjithshme si dhe legjislacioni në fuqi.

## **ORTAKET E SHOQERISE**

## **SAMIJE PAÇRAMI**

